



Jeta buron nga fshati

Parlamenti i tretë Rural Shqiptar 2023

11-13 TETOR 2023
NË AMBIENTET E UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Organizuar nga: Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
në bashkëpunim me 34 organizatat e veta anëtare
dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës

DEKLARATË



Ne, banorët e komuniteteve rurale të Shqipërisë,

Të vetëdijshëm për rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm rural dhe për përpjekjet tona në kuadër të Parlamentit Kombëtar Rural si një instrument për të avancuar demokracinë vendore, përfshirjen sociale, dhe për të nxitur progresin në integrimin evropian dhe arritjen e objektivave globale të OKB-së.

Të vetëdijshëm për pasurinë e madhe në burime natyrore dhe trashëgimi kulturore të komuniteteve rurale, si dhe për rëndësinë e tyre në sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Të shqetësuar për humbjen e burimeve të jetesës, eksodin e popullsisë, ndikimin e ndryshimeve klimatike, tkurrjen e ekonomisë lokale, varfërinë dhe përjashtimin social.

Të shqetësuar nga politika jo-efektive në zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe pritshmëri të paplotësuara në zbatimin e politikave evropiane për zhvillimin e qëndrueshëm vendor, siç është qasja Leader.

“Jeta buron nga fshati” na kërkon të ndërmarrim veprime konkrete për të rikthyer dinjitetin njerëzor dhe profesional të banorëve të zonave rurale: fermerëve, blegtorëve, barinjve, të rinjve dhe grave.

Sot, shumë banorë në komunitete të ndryshme rurale po përballen me humbjen e burimeve të jetesës për shkak të ndërhyrjeve të ndryshme që kanë ndikim negativ dhe të pashmangshëm në ekonominë lokale dhe në biodiversitet. Kapitali territorial në këto zona, i cili është pronë e banorëve po keqmenaxhohet duke shkaktuar varfërimin e banorëve dhe errësuar perspektivën për të jetuar, punuar dhe gëzuar në këto zona.

DEKLARATË

Kjo Deklaratë është hartuar në përfundim të Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar, i cili u zhvillua në muajin tetor 2023 dhe mbledhi rreth 600 aktorë të ndryshëm të interesit përgjatë tre ditëve. Ky takim mbarëkombëtar përgatiti terrenin për dialog dhe bashkëpunim konkret mes aktorëve të interesit, për të analizuar realitetin dhe për t'u njohur më mirë me nevojat dhe problemet, për të reflektuar mbi vizionin dhe prioritetet si dhe veprimet kolektive me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitetet rurale në të gjithë vendin.

Pjesëmarrësit e Parlamentit Rural Shqiptar kërkojnë me vendosmëri veprime konkrete për qeverisje të përgjegjshme dhe angazhim të të gjithë strukturave qeveritare të përfshira në bujqësi dhe zhvillimin rural.

Për këtë kërkojmë:

Vendosjen e partneritetit afatgjatë mes Parlamentit Kombëtar Rural me Kuvendin e Shqipërisë, veçanërisht Komisionin Parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Mjedisin dhe Tregtinë, për të mbikëqyrur zbatimin e kuadrit ligjor dhe ndërmarrjen e nismave të reja ligjore për çështje të ndryshme të identifikuara nga aktorë të ndryshëm pjesëmarrës në Parlamentin Rural Shqiptar;

Institucionalizimin e bashkëpunimit të Parlamentit Kombëtar Rural dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për organizimin e këtij takimi mbarëkombëtar në një periudhë dy-tre vjeçare, si një nevojë për të analizuar realitetin dhe për të dakordësuar prioritetet e agjendës kombëtare rurale, mundësuar nga një pjesëmarrje e rritur dhe e njëmendtë e aktorëve të ndryshëm të interesit.

Prioritetet e dakordësuara nga Parlamenti i tretë rural shqiptar janë:

Formulimi dhe zbatimi i politikave aktive, të qarta dhe të qëndrueshme të zhvillimit bujqësor dhe rural për të mbështetur dinamikën e sektorit dhe për të adresuar sfidat që lidhen si me tkurrjen e nën-sektorëve, rasteve të mbiprodhimit, çështjen e shitjes së produkteve nën kosto, dhe sigurimet për dëmtime në prodhimin bujqësor dhe blegtoral.

Rritja e mbështetjes buxhetore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural për skemën kombëtare për të mbështetur të gjithë fermerët që plotësojnë kriteret, pa baza konkurruese. Skema duhet të ristrukturohet gradualisht duke aplikuar efektin e ekualizimit të fondeve publike, duke diferencuar masat dhe fondet sipas rajoneve për të kontribuar në zhvillimin koheziv dhe të balancuar të komuniteteve vendore. Skema duhet të jetë e qëndrueshme, me masa mbështetëse të pandryshueshme për një periudhë 3-5 vjeçare, të bazuar në studime dhe procese konsultuese me pjesëmarrje për hartimin e tyre. Institucionalizimi i hartimit të skemës kombëtare me pjesëmarrjen e fermerëve dhe grupeve të tjera të interesit përmes rregullave dhe procedurave për njoftimin dhe konsultimin publik është domosdoshmëri.

Formulimi dhe zbatimi i politikave efektive dhe të njëllojta të zhvillimit rural janë të domosdoshme, veçanërisht në sfondin e mungesës së rezultateve konkrete të Programit të 100-fshatrave. Pavarësisht qëllimeve të mira të programeve të hartuara, zbatimi i tyre kërkon menaxhim të përgjegjshëm, transparencë dhe llogaridhënie. Prioritizimi i qasjes Leader për një sipërmarrje të mundshme mbarëkombëtare ka potencialin për të plotësuar vakumin e krijuar nga dështimi i Programit të 100 fshatrave dhe pritshmëritë e paplotësuara të qytetarëve ndaj Programit. Mbështetja e Grupeve vendore të veprimit ekzistuese, për të zbatuar Strategjitë e zhvillimit vendor për projekte të gjallërimit të territorit dhe projekte të vogla, si dhe ofrimi i mbështetjes për nismat vendore të llojit Leader në formalizimin e GVV-ve dhe hartimin e strategjive vendore, janë të nevojshme për të nxitur një sipërmarrje kombëtare të qasjes Leader në Shqipëri.

Formulimi dhe zbatimi i politikave nxitëse dhe stimuluese për zhvillimin e zonave malore dhe ato më pak të favorizuara. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të përkufizojë qartë zonat rurale dhe mes tyre ato më pak të favorizuara, të integrojë masa specifike mbështetëse dhe nivel subvencionimi më të rritur për fermerët në këto zona krahasuar me zonat e tjera jashtë këtij përkufizimi.

Kujdesi për komunitetin e barinjve dhe pastoralistëve, mbartësit e trashëgimisë kulturore jo-materiale të vendit tonë, të njohur nga UNESCO, që prej shekujsh jetojnë në simbiozë me natyrën, është i rëndësishëm për ruajtjen e stilit të jetesës të trashëguar brez pas brezi. Duke ruajtur historinë, traditën dhe identitetin e zonave malore shqiptare, komuniteti mbron këtë trashëgimi të çmuar. Kujdesi ndaj këtij komuniteti do t'u jepte jetë zonave alpine të renditura nga agjencitë prestigjioze ndërkombëtare si një prej destinacioneve që duhen vizituar. Mungesa e mbështetjes ndaj këtij komuniteti rrezikon humbjen e trashëgimisë kulturore, mundësitë e jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit, si dhe të habitatit dhe biodiversitetit.

Ne besojmë në rolin dhe kontributin e jashtëzakoshëm të komuniteteve rurale në progresin social ekonomik të vendit tonë. Sipas vizionit tonë, komunitetet rurale janë dinamike dhe kanë ekonomi të diversifikuara përmes turizmit rural. Ato ofrojnë mundësi për mirëqenie ekonomike dhe sociale, dhe mbrojnë mjedisin dhe biodiversitetin. "Jeta buron nga fshati" – është një e vërtetë e madhe se zhvillimi dhe përparimi i Shqipërisë vjen nga zonat e saj rurale.

Për të arritur këtë vizion, nevojitet një politikë aktive, e qëndrueshme dhe nxitëse në zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural, e cila fokusohet në nevojat, prioritetet dhe aspiratat e komuniteteve vendore. Na duhet një politikë që mbështet ekonominë rurale, investon në infrastrukturë publike, arsim dhe shëndetësi, krijon mundësi për komunitetet, veçanërisht të rinjtë, mbron burimet e jetesës së banorëve dhe ofron cilësi jetese të qëndrueshme tani dhe për të ardhmen, duke siguruar që fshatrat të mos braktisen.

Çështjet e trajtuara në këtë deklaratë janë mbi të gjitha, çështje të drejtësisë dhe barazisë sociale.

Parlamenti i tretë Rural Shqiptar 2023

Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD) është një rrjet i tridhjetë e katër OSHC-ve lokale me profile të konsoliduara në zhvillimin rural dhe i krijuar nga 'poshtë-lart' në vitin 2015 me synimin për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale në Shqipëri. ANRD është rrjet aktiv në fushën e politikave të zhvillimit rural, për të adresuar nevojën për politikëbërje efektive të zhvillimit rural përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të aktorëve jopublikë në formulimin dhe zbatimin e politikave të sektorit.

